



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

DREJTORIA E BUJQËSISË

Bazuar në Ligjin Nr. 02/L-53 për Gjuetinë, neni 37 paragrafi 37.4 dhe Udhëzimi Administrativ NR. 06/2009, neni 4, 5 dhe 6, Kuvendi Komunalë Prishtinë- Drejtoria e Bujqësisë shpall ofertë publike mbi dhënien në mbikëqyerje të vendgjuetive të përbashkëta që shtrihen në territorin e Prishtinës.

OFERTË PUBLIKE

Për dhënien në mbikqyerje të përkohëshme të vend-gjuetive të përbashkëta

- I. **Vendgjuetia: “Prishtina I” në sipërfaqe të përgjithshme prej 26349.02 hektar dhe sipërfaqe ku mund të zhvillohet gjuetia prej 18853.20 hektar;**
- II. **Vendgjuetia: “Prishtina II” në sipërfaqe të përgjithshme prej 11384.21hektar dhe sipërfaqe ku mund të zhvillohet gjuetia prej 7243.52 hektar dhe**
- III. **Vendgjuetia: “Prishtina III” në sipërfaqe të përgjithshme prej 12578.40hektar dhe sipërfaqe ku mund të zhvillohet gjuetia prej 12036.20 hektar**

KUSHTET E OFERTËS

1. **Kushtet kryesore për dhënien në mbikqyerje të përkohëshme të vend-gjuetive të përbashkëta janë:**

1.1. dëshmia e regjistrimit të veprimtarisë;

1.2. dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhimin me kafshë të egra dhe gjueti (kjo vlen për menaxhuesit e gjertanishëm me gjueti – shoqatat e gjuetisë) nga Federata e Gjahtarëve të Kosovës, si dhe përshkrimin e rezultateve menaxhuese nga vitet paraprake;

1.3. dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhim dhe rezultatet e arritura në veprimtari të ngjashme - për subjektet tjera juridike dhe fizike si në: pylltari, bujqësi, veterinë, turizëm, ekologji;

1.4. dëshmi për shërbimin profesional që do të angazhohet në menaxhim, duke përfshirë numrin e të punësuarve - gjuetarë të kualifikuar, roje gjuetie, profesionistë të florës dhe faunës;

1.5. programin për synimet e menaxhimit dhe zhvillimit të vendgjuetisë – mbrojtja dhe ruajtja, kultivimi dhe shtimi i kafshëve të egra;

1.6. dëshmi nga gjykata se personi përgjegjës nuk është i dënuar ose i ndjekur për vepër penale;

1.7. dëshmi që vërtetohet se nuk ka obligime financiare ndaj Agjencisë Tatimore të

Kosovës;

1.8. dëshmi për posedimin e mjaftueshëm të mjeteve financiare për ushtrimin e kësaj veprimtarie;

1.9. Ne kushte të barabarta, subjektet që kanë më shumë përvojë në fushën e menagjimit me gjueti do të kenë përparësi në përzgjedhje.

- Subjekt i ofertës është dhënia në mbikqyerje të përkohshme të vendgjuetive të lartëpërmenduar

-Subjektet përfituese do të jenë të obliguara dhe përgjegjëse për kultivimin dhe mbrojtjen e faunës së egër , ndersa lejohet vetem gjuetia sanitare dhe shkencore

Afati i aplikimit nga data 20.11.2017 deri më 28.11.2017

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës